FEDERATA E GJIMNASTIKËS E KOSOVËS
KOSOVA GYMNASTIC FEDERATION
VENDIMET NGA MBLEDHJA E BORDIT TË FGJK-SË

Bordi Ekzekutiv (BE) i FGJK-së, me datë 21 Maj 2026 duke filluar nga ora 16:00, mbajti mbledhjen e bordit në zyrën e FGJK-së, në Shtëpinë e Sportit në Prishtinë, duke ju përmbajtur rëndit të ditës.

REND I DITËS

1. **Hapja e mbledhjes nga Kryetari:** Mbledhja është hapur nga Kryetari i FGJK-së, Z. Shkumbin Maqastena, i cili falënderoj të pranishmit për pjesëmarrje në këtë mbledhje.
2. **Caktimi i një proces-mbajtësi:** Kryetari Z. Maqastena propozoj që procesmbajtës në këtë mbledhje të jetë Sekretari i Përgjithshëm, Z. Amir Tahiraga, të gjithë të pranishmit votuan pro, nuk kishte kundër apo abstenim.
3. **Verifikimi i pjesëmarrsëve në mbledhje, numri i tyre:** Në këtë pikë të rendit të ditës, u vërtetua se prezent në mbledhje ishin 6 anëtarë me të drejtë vote, gjithashtu prezent ishin edhe Sekretarin e Përgjithshëm, dhe Sekretari Teknik pa të drejtë vote e që në total 8 anëtarë të pranishëm.

   Të pranishëm në mbledhjë të BE të FGJK-së, ishin:

   1. Shkumbin Maqastena – Kryetar i FGJK-së,
   2. Sherife Aliçkaj Qerimi – Nënkryetare e FGJK-së,
   3. Besim Halilaj – Nënkryetar i FGJK-së
   4. Elfete Gashi – Anëtare e BE të FGJK-së, (online)
   5. Lisa Zeqiri – Anëtare e BE të FGJK-së,
   6. Besnik Latifi – Anëtar i BE të FGJK-së.
   7. Rizonë Mustafa – Anëtare e BE të FGJK-së,
   8. Ard Kryeziu – Anëtar i BE të FGJK-së,
   9. Amir Tahiraga – Sekretar i Përgjithshëm i FGJK-së, pa të drejtë vote.
   10. Arlind Shaqiri – Sekretar Teknik i FGJK-së pa të drejtë vote.
4. **Kampionati i Kosovës në Gjimanstikë Artistike për Femra dhe Meshkuj**: Në këtë pikë të rëndit të ditës u diskutuan mundësitë e mbajtjes së Kampionatit datat, koha dhe vendi, është aprovuar që Kampionati të mbahet me datë 20/06/2026, duke filluar nga ora 10:00, gjithashtu është diskutuar edhe mundësia e mbajtjes së Kampionatit në Sallë të madhe në Pallat të Rinisë dhe Sporteve, ose në Sallën e Shkollës “Don Bosko”, në Prishtinë, mirëpo për shkak se sallat në këto dy vende ishin zënë për datat e sekura me lartë është vendosur që Kampionati i Kosovës në gjimnastikë artistike për femra dhe meshkuj të mbahet në sallë të Fakultetit të Edukimit Fizik dhe Sportit, me datë 20/06/2026 duke filluar nga ora 10:00, në tri disiplina, në Parter (airtrack), Tra, dhe Kampërcime. Të gjithë të pranishmit votuan pro, nuk kishte kundër apo abstenime.
5. Është vendosur që të gjithë pjesëmarrësit, Stafi Menaxherial i FGJK-së, Anëtarët e BE të FGJK-së, Teknikët, Vullnetarët, Trajnerët etj, të kenë ID-në e akreditimit (badge). Të gjithë ishin pro nuk kishte kundër apo abstenime.

FGJK – KGF
Shtëpia e Sporteve, Rruga Agim Ramadani, 10000 Prishtinë, tel:044/145/009 email: kosovagymnasticsfederation@gmail.com

6. Është vendosur që secila tavolinë e gjyqtarisë të ketë flamurin e kuq dhe të gjelbërt, ku të gjithë votuan unanimisht, dhe u vendos që të porositën 5 flamuj të gjelbërt dhe 5 të kuq.
7. Është vendos që në këtë Kampionat të i bëhet ftesë Shqipërisë dhe Maqedonisë së Veriut për pjesëmarrje me 10 gjimnaste total, (5 gjimnaste para-yllka, yllka, pioniere, dhe 5 Juniore dhe Seniore), konfirmi nga këto dy federate pritet të arrijë në FGJK.
8. Është vendosur që të porositën flamujt: Kombëtar, Kosovës, KOK, FIG, të gjithë të pranishmit votuan pro, nuk kishte kundër apo abstenime.
9. Është vendosur që secila tavolinë të këtë mbulesën dhe flamuj të vegjel me logo të FGJK-së, gjithashtu është vendosur që përbërja e tavolinave në gara të ndryshoj, ku secili panel i gjyqtarisë do të ketë 2 ose 3 tavolina, Kryetari, Sekretari, Zëvëndës – Kryetarët do kenë tavolinën e tyre. Të gjithë votuan pro, nuk kishte kundër apo absetenime.
10. Është vendosur që gjyqtarët të dalin një orë më herët, (para-garës), ose njëri nga gjyqtarët të dal një ditë më herët për t'i kontrolluar pajisjet, materialin etj, gjithashtu është diskutuar që të caktohet krye-gjyqtari.
11. Është vendosur që vrojtuesit të mos kenë meditje përderisa janë duke e kryer këtë punë, gjithashtu është vendosur që pas 5 garave secili vrojtues të testohet dhe pastaj të del në gjyqatari të rregullt varësisht nga pesha e garës. Të gjithë votuan pro nuk kishte kundër apo abstenime.
12. Është vendosur që secili gjyqtarë të ketë fletorën e vetë të formatit A4, ku do të ketë vendin e vendosjes së emrit, datën, garën, disiplinën dhe çfarë paneli të gjyqtarisë është D, apo E, asnjë faqe e kësaj fletore nuk është e lejuar të shktrrohet (qkyhet), e njejta fletore do të përdoret për çdo garë, të organizuar nga FGJK, të gjithë votuan pro nuk kishte kundër apo abstenime.
13. Është vendosur që secili trajner i klubit që merr pjesë në garë të ketë veshje sportive, (trenerka)
14. Është vendosur që gjyqtarët të kenë veshje zyrtare, (pantollona me këmishë),
15. Është vendosur që vullnetaret të kenë veshje sportive, (trenerka, maica të gjata) dhe se nuk lejohen maicat e shkurtëra.
16. Është vendosur që të porositet platforma 1/2/3, për ndarjen e medaljeve.
17. Është vendosur që airtrack që është donacion të rregullohet dhe të vendoset për garë ose të merret nga KGJ "ELITA".
18. Është vendosur që të jepen medaljet për vendin 1,2,3, dhe për shumëgarësh të jenë medaljet me të veçanta, pa mirënjohje apo diplomë për pjesëmarrje. Të gjithë votuan pro, nuk kishte kundër apo abstenime.
19. Është vendosur që nëse një gjimnast apo gjimnaste merr pjesë në nivelin C të mund të marr pjesë në nivelin B mirëpo pas 6 muajsh nëse i përmbush kërkesat e kompozimit, ndërsa nga niveli C nuk mund të marr pjesë në

FGJK – KGF
Shtëpia e Sporteve, Rruga Agim Ramadani, 10000 Prishtinë, tel:044/145/009 email: kosovagymnasticsfederation@gmail.com

Kampionat, kurse nga niveli B dhe A gjimnasti/tja nuk mund të marr pjesë në nivelin C. të gjithë votuan pro nuk kishte kundër apo abstenime.

20. Është vendosur që të respektohet afati i regjistrimit dhe dërgimi i muzikave, në momentin që dërgohet emaili njoftues për garë dhe vendoset afati për regjistrim dhe për muzika, klubet pjesëmarrëse duhet që të dërgojnë formularët e regjistrimit dhe muzikat, klubet të cilat nuk respektojnë afatet, nuk do mund të regjistrojnë më dhe nuk do mund të marrin pjesë në atë garë. Nuk është e lejuar që gjimnastet e cilit do klub të paraqiten me telefona celular gjatë garës në tavolinën zyrtare për muzika të gjimnasteve. Për çdo regjistrim klubet duhet të dërgojnë formularet në emailin e garave fgjkgarat@gmail.com dhe cc: kosovagymnasticsfederation@gmail.com

21. Është vendosur që të gjitha rregulloret që janë në kompetencë të Bordit Ekzekutiv të rishikohen dhe përditësohen.

Mbledhja e BE të FGJK-së përfundoi me datë 21/05/2026 prundoj në ora 18:15.

Sekretar i Përgjithshëm i FGJK-së
Amir Tahiraga

FGJK – KGF
Shtëpia e Sporteve, Rruga Agim Ramadani, 10000 Prishtinë, tel:044/145/009 email: kosovagymnasticsfederation@gmail.com